

BREAKING NEWS

x

'S'DO LEME GUR PA LUAJTUR', KRYEMINISTRI RAMA NISËT DREJT SHBA DHE JEP LAJ...

AKTUALITET

Maskat grabisin karburantin në Vlorë, roja rrëfen si ua dha xhiron ditore nën kërcënimin e armës

SHKRUAR NGA SOT.COM.AL
9 SHKURT 2019

Facebook

WhatsApp

Twitter

Email



Maskat rikthehen sërish, ku këtë herë kanë goditur një karburant në qytetin e Vlorës. Dy persona të maskuar dhe nën kërcënimin e armës kanë grabitur një karburant në Novoselë. Grabitja ndodhi natën e së enjtes në të gdhirë të së premtës. Autorët nën kërcënimin e armës kanë marrë xhiron ditore të karburantit dhe janë larguar pa lënë gjurmë nga vendi i ngjarjes. Autorët e kësaj grabitjeje dyshohet se janë profesionistë, pasi ata kanë vepruar shumë shpejt. Mësohet se dy

grabitësit kanë marrë rreth 35 mijë lekë të rinj rojës. Ata thyen xhamin e kabinës ku qëndron roja dhe nën kërcënim i morën paratë e xhiros rreth 35 mijë lekë. Në dëshminë e tij, punonjësi i karburantit ka deklaruar se i kishte dëgjuar grabitësit të thonin nxirre pistoletën. Këto fjali duket se kanë qenë një mesazh për punonjësin e karburantit që të mos reagonte pasi mund të rrezikonte jetën. “Unë isha i ulur në karrige, nuk i pashë nga larg po në një distancë prej 4-5 m pashë dy persona që u drejtuan me vrap drejt vendit ku unë po qëndroja. Kur u afruan, pashë që ishin të maskuar sapo tentova të ngrihesha njëri nga ata tha nxirre pistoletën. Në këtë moment njëri nga dy personat ka nxjerrë një armë zjarri tip pistoletë dhe me tytën e saj ka thyer xhamin e vendit ku unë qëndroja. Më pas nën kërcënimin e armës më kanë thënë që ti jepja paratë që kisha dhe kanë marrë të gjithë xhiron ditore”, është shprehur gjatë marrjes së pyetje roja i karburantit të grabitur. Pasi kanë marrë paratë, grabitësit u larguan me shpejtësi duke përfutur edhe nga errësira në zonë. Ka qenë pikërisht roja i grabitur që menjëherë pasi autorët janë larguar ka lajmëruar policinë e cila ka shkuar menjëherë në vendin e ngjarjes. Policia ndërkohë kreu veprimet e para në vendngjarje, por ende nuk ka rënë në gjurmë të autorëve. Prej fillimit të vitit, grabitjet me maska janë kthyer në një fenomen shqetësues në të gjithë vendin. Objektiv kanë qenë bankat, bizneset por edhe shtëpitë. Rastet më të rënda janë regjistruar në Durrës, ku persona të armatosur iu futën në shtëpi një biznesmeni duke i marrë djalin, ndërsa në Tepelenë një çift tregtarësh u dhunuan gjatë grabitjes. Grabitjet me armë e maska janë kthyer në një fenomen shqetësues që në nisje të vitit, me disa dhjetëra raste në të gjithë vendin, ku shumica e autorëve nuk janë kapur.

Hetimet

Pas telefonatës të mbërritur në sallën operative për grabitjen e karburantit në Novoselë menjëherë aty shkuan uniformat blu të Vlorës. Pas marrjes në pyetje të

rojes së objektit policia sekuestroi kamerat e sigurisë për identifikimin e autorëve. Burime nga grupi hetimor bëjnë me dije se nga kamerat e sigurisë duken dy persona të cilët të maskuar dhe me armë në dorë kërcënojnë rojën dhe i marrin paratë. Të njëjtat burime sqarojnë se identifikimi i autorëve është i vështirë pasi ata kanë qenë të maskuar. Hetuesit dyshojnë se grabitësit kanë qenë profesionist pasi nuk kanë lënë gjurmë gjatë grabitjes dhe kanë vepruar shpejt. Burimet thonë se ata kanë kryer grabitjen për një periudhë kohore prej 1 minute. Policia ka shoqëruar në komisarariat disa persona me precedent penal në zonë dhe po merren në pyetje. Në lidhje me ngjarjen ka reaguar dhe policia e qytetit bregdetar të Vlorës nëpërmjet një deklarate për mediat. Në deklaratë policia tha se ngjarja ka ndodhur rreth orës 02:35 të mëngjesit të djeshëm. Policia e mbyll deklaratën e saj duke thënë se është duke punuar për identifikimin dhe kapjen e autorëve.

Elvis Myrta

YOU MAY LIKE

by **mgid**



Milioner iz Beograd otkriva kako
zarađuje 400 evra na sat

BITCOIN ERA